



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

“PARTNERITETI PER QEVERINE E HAPUR” 2020 – 2022”

Komponenti nr 3. “Aksesi në drejtësi”

Minutat e takimit

05 Tetor 2020

Hyrje

Në kuadër të punës për hartimin e draft planit të veprimit lidhur me komponentin nr. 3, “ Aksesi në drejtësi” të Partneritetit për Qeverisjen e Hapur 2020-2022, më datën 05.10.2020 pranë Ministrisë së Drejtësisë nën masat e nevojshme në kushtet e COVID- 19 u zhvillua takimi konsultativ me grupet e interesit.

Takimi u hap nga Znj.Elona Hoxha, duke falenderuar gjithë përfaqësuesit e grupeve të interesit për bashkëpunimin në dërgimin e kontributeve dhe angazhimin e tyre në këtë proces, i cili do të ndihmojë në realizimin me sukses të këtij komponenti duke filluar nga faza konsultative deri në përfundimin e tij. Më tej, realizoi një përmbledhje të të gjitha fazave të realizuara deri në atë moment dhe informoi pjesëmarrësit në lidhje me qëllimin e takimit i cili ishte prezantimi i komponentit nr.3 “Aksesi në drejtësi” të Partneritetit për Qeverisjen e Hapur 2020-2022 për krijimin i një ure lidhëse komunikimi mes Shoqërisë Civile dhe Ministrisë së Drejtësisë, në funksion të hartimit së bashku të draft planit të veprimit lidhur me këtë komponent.

Më pas fjala kaloi tek Znj.Suzana Frashëri e cila vijoi me prezantimin tek të pranishmit e takimit, fillimisht duke shprehur mirënjohje për pjesëmarrjen dhe duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit dhe përfshirjen e tyre në proces. Znj.Frashëri informoi të pranishmit në mënyrë të përmbledhur në lidhje me Komponentin nr.3 “Aksesi në drejtësi” të OGP, e cila shprehet se aksesi në drejtësi konsiderohet si një nga komponentët kyç të qeverisë shqipëtare duke u vlerësuar si një nga parimet kryesor të sundimit të ligjit. Qeverisja e Hapur për Aksesin në Drejtësi duhet t’ju sigurojë qytetarëve akses, transparencë dhe llogaridhënie. Gjithashtu, ndihmon për të luftuar fenomenin e korrupsionit në të gjitha nivelet e ekspozimit të tij, duke e minimizuar dhe synuar një shoqëri sa më demokratike. Kontribuon në një qeveri llogaridhënëse; Kontribuon në sundimin e ligjit dhe krijimin e një shoqërie demokratike.

Në vijim, ekspertje nga Kryeministria Courtney McLaren, vijoi me një prezantim konkret të këtij procesi duke prezantuar edhe shembuj nga vendet e tjera, si dhe duke nxitur pjesëmarrësit për të qenë sa më aktiv në këtë proces me ide dhe propozime konkrete.

Më pas, fjala kaloi tek të pranishmit për t’ju bashkuar diskutimit me mendime dhe sugjerime në lidhje me këtë draft plan veprimi, si dhe çështje të tjera që mund të adresohen lidhur me këtë komponent. Fillimisht fjala kaloi tek Znj.Petrina Broka, Përfaqësuese e Klinikës së Ligjit pranë Fakultetit të Drejtësisë, duke shprehur sugjerimet dhe hapa konkretë sesi mund të zhvillohet dhe përmirësohet aksesi në drejtësi. Konkretisht, Znj. Broka vendosi theksin tek:

- Forcimin dhe fuqizimin e mëtejshëm të Klinikës së Ligjit dhe rrjedhimisht, të grupeve në nevojë, përmes ofrimit të shërbimit ligjor, rritjes së kapaciteteve dhe aftësive praktike të studentëve të Klinikës në dhënien e ndihmës ligjore falas, për shtresat në nevojë duke ju referuar konkretisht bashkëpunimit me Drejtorinë e Ndihmës Ligjore Falas.
- Organizimi i kurseve trajnuese për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive, rezultati i të cilit synohet përmirësimi i cilësisë së shërbimeve, aplikimi i standardeve adekuate gjatë procesit të punës në gjykata dhe prokurori.
- Pavarësisht arritjes së parashikimit të padive me shuma të vogla, nevojitet përmirësim i legjislacionit. (Dispozitat 399 të Kodit të Procedurës Civile dhe në vijim). Gjithashtu, i kushtoi rëndësi dhe përmirësimit të padive kolektive.
- Shprehu interes për të qënë pjesë e tryezave dhe bashkëpunim më të madh për konsultime më efektive publike në lidhje me disa projektligje të cilat janë në fazë hartimi, ku konkretisht theksoi projektligjin për arbitrazhin.

Në vijim të diskutimit, fjala kaloi tek Znj. Xhulia Mulla duke theksuar se:

Ndihma juridike e garantuar nga shteti si mënyrë efiçente dhe efektive është një nga format më thelbësore të aksesit në drejtësi. Aktualisht, ka 6 marrëveshje bashkëpunimi me 6 klinika, ku Fakulteti i Drejtësisë ka qënë ndër të parët që ka shprehur interes. Brenda këtij viti, është planifikuar takim me të gjitha klinikat për rrjedhoje e bashkëpunimit më të plotë. Aktualisht, janë aktive duke dhënë shërbim 5 qendra, ku synohet brenda këtij viti të jenë funksionale dhe qendra të tjera, konkretisht pranë qyteteve Pogradec, Gjirokastër etj.

Më pas fjalën e morri për diskutim, Z. Jozef Shkambi nga shoqëria civile CRCA duke shprehur në vija të përgjithshme rëndësinë që ka rritja e besimit të qytetarëve tek aksesit në drejtësi. Z. Shkambi i kushtoi rëndësi pjesës së vonës që haset në lidhje me fazën e hartimit dhe zbatimit të ligjeve. Sugjeroi krijimin e mekanizmave për të realizuar matjen e zbatimit të legjislacionit. Konkretisht duke iu referuar Ndihmës Juridike Falas, në rrethe të caktuara qytetarët hasen me pamundësinë për zbatimin e ligjit si rrjedhoje e mungesës së kapaciteteve apo problematikave të tjera.

Fjala kaloi tek ekspertja e OGP, Znj. Courtney McLaren e cila, falenderoi të pranishmit për angazhimin dhe bashkëpunimin e tyre lidhur me procesin, vlerësoi prezencën e të pranishmëve dhe vijoi me prezantimin. Në përfundim, znj. Hoxha njoftoi të pranishmit se takimi konsultues i rradhës do të zhvillohet në datën 13 tetor online.